L I G J
Nr.9589, datë 25.7.2006

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË HUASË NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (BERZH) PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT "ZHVILLIMI I RRUGËVE NË BASHKINË E TIRANËS""

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e huasë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për financimin e projektit "Zhvillimi i rrugëve në Bashkinë e Tiranës"".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5009, datë 4.8.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE HUAJE
(PROJEKTI PËR ZHVILLIMIN E RRUGËVE TË BASHKISË SË TIRANËS)

Marrëveshje e datës (_____) 2006 ndërmjet Republikës së Shqipërisë ("Huamarrësi") dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim ("Banka").

Hyrje

Duke pasur parasysh që Banka është krijuar për të siguruar financime për projekte të veçanta për të nxitur kalimin drejt ekonomive me orientim ndaj tregut të lirë dhe për t'i dhënë shtysë nismës private dhe sipërmarrëse në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore të përkushtuara ndaj, dhe që zbatojnë parimet e demokracisë shumëpartiake, pluralizmit dhe të ekonomisë së tregut;

duke pasur parasysh që Huamarrësi ka për qëllim të vërë në jetë projektin siç është përshkruar në Programin 1, i cili është përcaktuar që të ndihmojë në rehabilitimin dhe zhvillimin e rrugëve në Bashkinë e Tiranës ("Entiteti i Projektit");

duke pasur parasysh se pjesët A – 1, A – 2, A – 3 dhe A – 4 të Projektit do të kryhen nga Entiteti i Projektit me ndihmesën financiare të Huadhënësit;

duke patur parasysh se pjesët B – 1 dhe B – 2 të Projektit do të kryhen nga Entiteti i Projektit;

duke pasur parasysh që Huadhënësi ka kërkuar ndihmesë nga Banka për financimin e një pjese të Projektit;

duke pasur parasysh se Banka është në procesin e rregullimit të fondeve të bashkëpunimit teknik mbi bazën e një granti për të ndihmuar në vënien në jetë të Projektit; dhe

duke pasur parasysh që Banka ka rënë dakord mbi bazën e, ndër të tjera (inter alia), sa më sipër, që t'i japë një hua Huamarrësit në shumën e 14,600,000 euro, sipas termave dhe kushteve të referuara në këtë Marrëveshje dhe në marrëveshjen e projektit të datës së këtushme ndërmjet Entitetit të Projektit dhe Bankës ("Marrëveshja e Projektit" siç përcaktohet në termat dhe kushtet standarde),

tashmë, si rrjedhim, palët bien dakord për sa vijon:

Neni 1
Termat dhe kushtet standarde, përkufizime

Ndarja 1.01 Mishërimi i termave dhe kushteve standarde

Të gjitha dispozitat e termave dhe kushteve standarde të Bankës të datës 1 maj 2006 mishërohen këtu e në vijim dhe bëhen të zbatueshme ndaj kësaj Marrëveshjeje me të njëjtën fuqi dhe efekt sikurse të ishin përcaktuar plotësisht këtu (dispozita të tilla do të quhen që këtu e tutje "Termat dhe kushtet standarde").

Ndarja 1.02 Përkufizime

Kudo që të jenë përdorur në këtë Marrëveshje (përfshirë hyrjen dhe programet), përveçse kur deklarohet ndryshe apo kur konteksti ndryshe kërkon, termat e përcaktuar tek hyrja kanë kuptimet përkatëse që u është dhënë atyre aty, termat e përcaktuar në termat dhe kushtet standarde kanë kuptimet përkatëse që u është dhënë atyre aty dhe termat në vijim kanë kuptimet në vijim:

"Përfaqësues i Autorizuar i Huamarrësit"	nënkupton Ministrin e Financave të Huamarrësit, përveç si përcaktohet veçanërisht në ndarjen 2.04.
"Vit fiskal"	nënkupton vitin fiskal të Huamarrësit që fillon më 1 janar të çdo viti.
"Vëzhguesi Teknik i Huadhënësit"	nënkupton këshilltarin të cilit i bëhet referim në ndarjen 5.01 (e).
"Llogari e posaçme"	nënkupton llogarinë e posaçme të depozitës të cilës i bëhet referim në ndarjen 2.03 dhe në programin 3.
"Marrëveshja Shtesë e Huasë"	nënkupton marrëveshjen e huasë në të cilën do të hyhet nga Entiteti i Projektit dhe nga Huamarrësi sipas ndarjes 3.01 (a), siç një marrëveshje e tillë huaje mund të shtohet kohë pas kohe.

Ndarja 1.03 Interpretimi

Në këtë Marrëveshje, referimi te një nen, ndarje apo program i veçantë do të interpretohet, përveçse kur në këtë Marrëveshje deklarohet ndryshe, si referim tek ai nen apo ndarje e, apo program i kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2
Termat kryesore të huasë

Ndarja 2.01 Shuma dhe monedha

Banka bie dakord që t'i japë hua Huamarrësit, sipas termave dhe kushteve të vendosura apo të referuara në këtë Marrëveshje, shumën prej 14,600,000 euro.

Ndarja 2.02 Terma të tjera financiare të huasë

a) Shuma minimale për tërheqje do të jetë 100,000 euro.

b) Shuma minimale për parapagesë do të jetë 100,000 euro.

c) Shuma minimale për shuarje do të jetë 100,000 euro.

d) Data e pagesës së interesit do të jenë 6 qershori dhe 6 dhjetori i çdo viti.

e) Huamarrësi do të ripaguajë principalin e Huasë në datat në vijim dhe në shumat në vijim:

Data e ripagimit të huasë	Kësti A	Kësti B	Detyrimi për shumën e Principalit
6 qershor 2009	€341,670	€266,670	€608,340
6 dhjetor 2009	€341,670	€266,670	€608,340
6 qershor 2010	€341,670	€266,670	€608,340
6 dhjetor 2010	€341,670	€266,670	€608,340
6 qershor 2011	€341,670	€266,670	€608,340
6 dhjetor 2011	€341,670	€266,670	€608,340
6 qershor 2012	€341,670	€266,670	€608,340
6 dhjetor 2012	€341,670	€266,670	€608,340
6 qershor 2013	€341,670	€266,670	€608,340
6 dhjetor 2013	€341,670	€266,670	€608,340
6 qershor 2014	€341,670	€266,670	€608,340
6 dhjetor 2014	€341,670	€266,670	€608,340
6 qershor 2015	€341,670	€266,670	€608,340
6 dhjetor 2015	€341,670	€266,670	€608,340
6 qershor 2016	€341,670	€266,670	€608,340
6 dhjetor 2016	€341,670	€266,670	€608,340
6 qershor 2017	€341,670	€266,670	€608,340
6 dhjetor 2017	€341,670	€266,670	€608,340
6 qershor 2018	€341,670	€266,670	€608,340
6 dhjetor 2018	€341,670	€266,670	€608,340
6 qershor 2019	€341,670	€266,670	€608,340
6 dhjetor 2019	€341,670	€266,670	€608,340
6 qershor 2020	€341,670	€266,670	€608,340
6 dhjetor 2020	€341,590	€266,590	€608,180
Shuma e përgjithshme	€8,200,000	€6,400,000	€14,600,000

Kohë pas kohe ndërsa Huaja tërhiqet, këto tërheqje do të caktohen nga Banka për ripagimin në secilën nga datat e mbetura të përcaktuara më lart në shuma që janë pro rata (në ndarje të përpjesshme sipas interesit) me shumat e késteve përkatëse të mbetura të Huasë të përcaktuara më lart përkundrejt atyre datave (duke rregulluar banka këto shuma të caktuara siç është e nevojshme me qëllim që në çdo rast të arrihet numri i plotë). Për aq sa cilado tërheqje është bërë pas një apo më shumë nga datat e përcaktuara më lart, të tilla shuma të caktuara mund të rezultojnë në atë që késtet e mbetura të Huasë të jenë më të mëdha se sa shumat e principalit të përcaktuara më lart.

f) Data e Fundit e Mundshme do të jetë 31 dhjetor 2008 apo një datë e tillë mëvonshme që Banka mund, mbi vlerësimin e saj, ta vendosë dhe t'ia njoftojë Huamarrësin. Nëse Shuma e Disponueshme e Huasë, apo cilado pjesë e saj, i nënshtrohet një Norme Interesi Fikse dhe Banka e shtyn Datën e Fundit të Mundshme, Huamarrësi do t'i paguajë Bankës menjëherë shuma të tilla të Shpenzimeve të Paparashikueshme siç edhe do të njoftohet, kohë pas kohe, nga Banka me shkrim ndaj Huamarrësit.

g) Norma e Tarifës së Veprimeve do të jetë 0.5 % për vit.

h) Huaja i nënshtrohet një Norme të Ndryshueshme Interesi. Pavarësisht nga sa më sipër, Huamarrësi mund të zgjedhë, si një alternativë ndaj pagesës së interesit me një Normë Interesi të Ndryshueshme mbi të gjithë apo ndonjë pjesë të Huasë që kërkohet në atë moment, që të paguajë interesin me një Normë Interesi Fikse mbi një pjesë të tillë të Huasë në përputhje me ndarjen 3.04 (c) të termave dhe kushteve standarde.

Ndarja 2.03 Tërheqjet dhe llogaritë e posaçme

a) Shuma e disponueshme mund të tërhiqet kohë pas kohe në përputhje me dispozitat e programit 2 për të financuar (1) shpenzimet e bëra (ose, nëse Banka është dakord, shpenzimet që do të bëhen) në lidhje me kostot e mallrave, punimeve dhe shërbimeve të kërkuara për projektin dhe (2)

komisionin (bankar) të përgjithshëm.

b) Huamarrësi do të çelë dhe mbajë, për qëllimet e projektit, një llogari depozite të posaçme të vlerësuar në Monedhën e Huasë në një bankë tregtare të pranueshme për Bankën në terma dhe kushte të pranueshme për Bankën, duke përfshirë këtu mbrojtje të përshtatshme ndaj kundërshtive, konfiskimeve dhe sekuestrimeve. Nëse Huamarrësi dëshiron të bëjë tërheqje për të depozituar në, dhe pagesa të drejtpërdrejta nga, Llogaria e Posaçme (në vend të tërheqjeve të bëra sipas ndarjes 2.03 (a)), të tilla tërheqje do të bëhen në përputhje me dispozitat e programit 3.

Ndarja 2.04 Përfaqësuesi i autorizuar për tërheqjet

Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit i Huamarrësit përcaktohet si Përfaqësuesi i Autorizuar i Huamarrësit për qëllimin e ndërmarrjes së çfarëdo veprimi në lidhje me pjesën A – 5 të projektit, veprim i kërkuar apo i lejuar për t'u ndërmarrë sipas dispozitave të ndarjes 2.03 (a) dhe sipas dispozitave të ndarjeve 3.01 e 3.02 të termave dhe kushteve standarde. Kryetari i Bashkisë i Entitetit të Projektit përcaktohet si Përfaqësuesi i Autorizuar i Huadhënësit për qëllimin e ndërmarrjes së çfarëdo veprimi në lidhje me pjesët A – 1, A – 2, A – 3, A – 4, B – 1 ose B – 2 të projektit, veprim i kërkuar apo i lejuar për t'u ndërmarrë sipas dispozitave të ndarjes 2.03 (a) dhe sipas dispozitave të ndarjeve 3.01 dhe 3.02 të termave dhe kushteve standarde.

Neni 3
Zbatimi i projektit

Ndarja 3.01 Paktet e tjera pohuese të projektit

Huadhënësi, veç atyre që ka marrë përsipër përgjithësisht, të përcaktuara këto në nenet IV dhe V të termave dhe kushteve standarde, përveçse kur Banka bie dakord ndryshe:

a) do të vërë në përdorim të Entitetit të Projektit, sipas një marrëveshjeje huaje të kënaqshme për Bankën në formë dhe përmbajtje, një pjesë të shumave të Huasë në terma dhe kushte të pranueshme për Bankën dhe që përfshijnë termat e kushtet në vijim:

1) interesi dhe tarifa të tjera do të jenë të pagueshme në të njëjtën shkallë siç janë të zbatueshme për Huanë sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe

2) programi i ripagimit dhe maturimi përfundimtar do të jetë i njëjti si për këstin A të Huasë sipas kësaj Marrëveshjeje.

b) do të ushtrojë të drejtat e tij sipas Marrëveshjes Shtesë të Huasë në një mënyrë të tillë për të mbrojtur interesat e Huamarrësit dhe të Bankës, për t'u përputhur me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe për të përmbushur qëllimet për të cilat Huaja është dhënë;

c) nuk do të caktojë, shtojë, anulojë apo heqë dorë nga cilado dispozitë e Marrëveshjes Shtesë të Huasë, përveçse kur Banka bie dakord ndryshe;

d) do të bëjë që Projekti i Entitetit të përmbushë të gjitha detyrimet e tij sipas Marrëveshjes së Projektit, duke përfshirë pa kufizim detyrimet e tij që lidhen me:

1. ngritjen dhe veprimin e një njësie të vënien në jetë të projektit siç parashikohet nga ndarja 2.03 e Marrëveshjes së Projektit;

2. blerjen e mallrave, punimeve dhe shërbimeve për projektin siç parashikohet nga ndarja 2.04 të Marrëveshjes së Projektit;

3. çështjet mjedisore dhe sociale siç parashikohet në ndarjen 2.05 të Marrëveshjes së Projektit;

4. punësimin dhe përdorimin e këshilltarëve për të ndihmuar në vënien në jetë të Projektit siç parashikohet në ndarjen 2.06 të Marrëveshjes së Projektit;

5. përgatitjen dhe paraqitjen e raporteve në lidhje me veprimtarinë e Projektit dhe të Entitetit të Projektit siç parashikohet në ndarjen 2.07 të Marrëveshjes së Projektit;

6. ruajtjen e procedurave, regjistrave dhe llogarive, përgatitjen, kontrollin dhe paraqitjen ndaj Bankës të deklaratave financiare si edhe për dhënien Bankës të çfarëdo informacioni tjetër përkatës që lidhet me Projektin ose me veprimet e Entitetit të Projektit siç parashikohet në ndarjen 3.01 të Marrëveshjes së Projektit; dhe

7. përputhjen me të gjitha rregullat që lidhen me aspektet operacionale dhe financiare të Projektit dhe të Entitetit të Projektit siç parashikohet në ndarjet 3.02, 3.03 dhe 3.04 të Marrëveshjes së projektit; dhe

e) do të ndërmarrë apo do të bëjë që të ndërmerren, të gjitha veprimet e nevojshme shtesë për të siguruar fondet e përshtatshme për përmbushjen e projektit.

Ndarja 3.02 Njësia për vënien në jetë të Projektit

Me qëllim që të bashkërendohen, drejtohen, vëzhgohen dhe vlerësohen të gjitha aspektet e vënies në jetë të Projektit, duke përfshirë këtu blerjen e mallrave, punimeve e shërbimeve për Projektin, Huamarrësi do të vërë në veprim, përveçse kur bihet dakord ndryshe me Bankën, në çdo kohë gjatë zbatimit të Projektit një njësi për vënien në jetë të projektit me burime të përshtatshme dhe me personel të kualifikuar në mënyrë të përshtatshme, si edhe me synime dhe përgjegjësi të pranueshme për Bankën.

Ndarja 3.03 Prokurimi

Për qëllimet e ndarjes 4.03 të termave dhe kushteve standarde, dispozitat në vijim do të rregullojnë blerjen e mallrave, punimeve e shërbimeve të kërkuara për pjesën A – 5 të Projektit dhe për t'u financuar nga shumat e Huasë, përveçse kur Banka bie dakord ndryshe:

a) Mallrat, punimet dhe shërbimet (të tjera nga ato të shërbimeve të këshilltarëve të cilat përfshihen brenda ndarjes 3.03 (c) do të blihen me tenderim të hapur.

b) Për qëllimet e ndarjes 3.03 (a), procedurat për tenderimin e hapur, tenderimin përzgjedhës, tenderimin e vetëm dhe ... si edhe standardet për procedurat për tenderimin konkurrues vendor përcaktohen në kreun 3 të rregullave të prokurimit të BERZH.

c) Këshilltarët që do të punësohen nga Huamarrësi për të ndihmuar në përmbushjen e Projektit do të zgjidhen në përputhje me procedurat e përcaktuara në kreun 5 të rregullave të prokurimit të BERZH.

d) Të gjitha kontratat do t'u nënshtrohen procedurave të rishikimit të përcaktuara në shtojcën 1 të rregullave të prokurimit të BERZH. Të gjitha kontratat do t'i nënshtrohen një rishikimi paraprak.

e) Për çfarëdo kontrate, në lidhje me të cilën duhet të bëhet një pagesë nga Llogaria e Posaçme, procedurat e prokurimit do të ndiqen që sigurojnë që kërkesat për rishikim të ndarjes 3.03 (d) janë plotësuar përpara bërjes së pagesës së parë nga Llogaria e Posaçme në lidhje me një kontratë të tillë.

Ndarja 3.04 Paktet mjedisore dhe për përputhshmërinë sociale

Pa kufizuar veprimin e përgjithshëm të ndarjeve 4.02 (a), 4.04 (a) (iii) dhe 5.02 (c) (iii) të termave dhe kushteve standarde, nëse Banka nuk bie dakord ndryshe, Huamarrësi:

a) përveç sa përcaktohet ndryshe në Planin e Veprimit Social dhe të Drejtimit Mjedisor (siç është përcaktuar në Marrëveshjen e Projektit), do të kryejë pjesën A – 5 të Projektit në përputhje me rregulloret dhe standardet mjedisore në fuqi kohë pas kohe në juridiksionin në të cilin është vendosur Projekti dhe me standardet mjedisore që ekzistojnë në Bashkimin Europian në datën e atëhershme (ose, në rast se të tilla standarde nuk ekzistojnë në Bashkimin Europian, siç është përcaktuar në udhëzimet e zbatueshme të Grupit të Bankës Botërore) dhe në Politikat e Sigurisë së Korporatës Financiare Ndërkombëtare mbi Popujt Vendas, Rivendosjen e Pavullnetshme dhe në Pronësinë Kulturore siç ato referohen në Politikën Mjedisore të Bankës në datën a atëhershme;

b) do të vëzhgojë mbi gjitha ligjet dhe standardet e zbatueshme mbi punësimin, duke përfshirë këtu ato që lidhen me punësimin e fëmijëve dhe të rinjve diskriminimin në punë, dhe me punën e detyruar, dhe ligje e standarde të tilla të zbatueshme do të përfshijnë (i) konventat themelore të Organizatës Ndërkombëtare të Punës në lidhje me zhdukjen e punës së fëmijëve, zhdukjen e diskriminimit në vendin e punës dhe me zhdukjen e punës së detyruar apo të detyrueshme dhe (ii) ligjet e vendit; dhe

c) do të vërë me përkushtim në jetë dhe do të aderojë në Planin e Veprimit Social dhe të Drejtimit Mjedisor në lidhje me pjesën A – 5 të Projektit.

Ndarja 3.05 Këshilltarët

a) Me qëllimin për të ndihmuar në vënien në jetë të Projektit, Huamarrësi do të punësojë apo të krijojë kushte për punësimin, sipas kërkesës, nëse Banka nuk bie dakord ndryshe, dhe do të përdorë këshilltarë, kualifikimet, përvoja dhe termat e referencës të të cilëve janë të kënaqshme për Bankën, duke përfshirë këshilltarët për të ndihmuar NjVJP në skicimin dhe mbikëqyrjen e pjesës A – 5 të Projektit.

b) Huamarrësi do të sigurojë, pa tarifë, për cilëtdo këshilltarë të përfshirë për të ndihmuar në çështje që lidhen me Projektin apo veprimet e Huamarrësit të gjitha mjediset dhe mbështetjen e nevojshme për të kryer funksionin e tyre, përfshirë të gjitha dokumentet, materialet dhe informacione të tjera që mund të jenë të përshtatshme për punën e tyre.

Ndarja 3.06 Shpeshtësia e raportimit dhe kërkesat për paraqitje

a) Duke filluar nga Data Efektive, deri sa shuma e plotë e Huasë të jetë ripaguar apo shuar, Huamarrësi do të paraqesë para Bankës raporte vjetore mbi çështje mjedisore dhe çështje sociale që vijnë në lidhje Huamarrësin apo pjesën A – 5 të Projektit, siç referohet në ndarjen 5.02 (c) (iii) të termave dhe kushteve standarde, brenda 120 ditëve pas përfundimit të vitit që po raportohet. Raporte të tilla do të përfshijnë informacion mbi çështjet e veçanta në vijim:

1) informacion mbi përputhshmërinë me kërkesat mjedisore, shëndetësore, sociale e të sigurisë të pacaktuara në ndarjen 3.04, duke përfshirë këtu gjendjen e çfarëdo lejesh mjedisore të kërkuara për pjesën A – 5 të Projektit, rezultatet e cilavedo inspektime të kryera nga cilido autoritet rregullator, çdo dhunim të ligjeve, rregulloreve apo standardeve të zbatueshme dhe çfarëdo veprimi me qëllim shpërblim dëmi të lidhur me to si edhe cilatdo gjoba të vëna për shkelje të tilla;

2) informacion mbi vënien në jetë të Planit të Veprimit Social dhe të Drejtimit Mjedisor, duke përfshirë çfarëdo ndryshime të propozuara të veprimeve, programeve apo shpenzimeve;

3) një përmbledhje çfarëdo e shënimeve, raporteve dhe komunikimeve të tjera materiale mbi çështje mjedisore dhe çështje sociale të paraqitur në lidhje me pjesën A – 5 të Projektit para cilitdo autoritet rregullator;

4) informacion mbi regjistrin e shëndetit dhe sigurisë së pjesës A – 5 mbi Projekt, duke përfshirë shkallën e aksidenteve dhe çdo nismë tjetër në lidhje me çështje të shëndetit e sigurisë të cilat janë zbatuar apo planifikuar;

5) një përmbledhje të çfarëdo ndryshimeve në ligjet mjedisore, shëndetësore dhe të sigurisë të cilat mund të kenë një pasojë materiale mbi pjesën A – 5 të Projektit; dhe

6) kopje të informacionit mbi çështje mjedisore dhe çështje sociale në lidhje me pjesën A – 5 të Projektit periodikisht të paraqitur përpara publikut të gjerë.

b) Duke filluar nga Data Efektive, Huamarrësi do të paraqesë raportet e herëpashershme të Projektit të referuar në ndarjen 4.04 (a) (iv) të termave dhe kushteve standarde çdo tre muaj, brenda 30 ditësh pas përfundimit të periudhës që është duke u raportuar, derisa të përmbushet Projekti. Raporte të tilla do të përfshijnë karakteristikat e veçanta në vijim në lidhje me pjesën A – 5 të Projektit:

1) Informacionin e përgjithshëm në vijim:

A) përparimin fizik të arritur në vënien në jetë të pjesës A – 5 të Projektit deri në datën e raportit dhe gjatë periudhës që raportohet;

B) vështirësitë apo vonesat e tanishme apo të pritura në vënien në jetë të pjesës A – 5 të Projektit dhe pasojën e tyre mbi programin e vënies në jetë, si edhe hapat e tanishme të ndërmarra apo të planifikuara për të kapërcyer vështirësitë e shmangur vonesat;

C) ndryshimet e pritura në datën e përmbushjes së pjesës A – 5 të Projektit;

D) ndryshimet e personelit kyç në burimet njerëzore të NjVJP, këshilltarët apo kontraktorët;

E) çështje që mund të prekin koston e pjesës A – 5 të Projektit; dhe

F) çfarëdo zhvillimi apo veprimtarie që mund të prekë leverdinë ekonomike të pjesës A – 5 të Projektit.

2) Deklarimet financiare që tregojnë hollësi të shpenzimeve të ndodhura nën pjesën A – 5 të Projektit dhe tërheqjet, bashkë me një deklarim që tregon:

A) vlerësimet e kostos origjinale;

B) vlerësimet e kostos së rishikuar, nëse ka, bashkë me arsyet për ndryshimet;

C) shpenzimet e vlerësuara origjinale dhe shpenzimet e tanishme deri në këtë datë;

D) arsyet për ndryshimin e shpenzimeve të tanishme deri në këtë datë nga shpenzimet e vlerësuara origjinale deri në këtë datë; dhe

E) shpenzimet e vlerësuara për tremujorët e mbetur të vitit.

c) Menjëherë pasi ndodh çfarëdo incident apo aksident në lidhje me pjesën A – 5 të Projektit, i cili ka mundësi që të ketë një pasojë materiale të pafavorshme mbi mjedisin, shëndetin apo sigurinë, Huamarrësi do t’i japë njoftim Bankës me anë të transmetimit faks apo teleks duke përcaktuar në veçanti natyrën e një incidenti apo aksidenti të tillë dhe çfarëdo hapash që Huadhënësi po ndërmerr për të rregulluar këtë. Pa kufizuar veprimin e përgjithshëm të sa thënë më sipër, një incident apo aksident ka shumë mundësi të ketë një pasojë materiale të pafavorshme mbi mjedisin, shëndetin apo sigurinë nëse çfarëdo ligji i zbatueshëm kërkon njoftimin e një incidenti apo aksidenti të tillë ndaj cilitdo autoritet qeveritar, nëse një incident apo aksident i tillë përfshin fatkeqësi, apo dëmtime të shumta e të rënda që kërkojnë shtrimin në spital apo nëse një incident ose aksident i tillë është bërë publikisht i njohur përmes mbulimit të medias apo në tjetër mënyrë.

Neni 4
Pezullimi, përshpejtimi, shuarja

Ndarja 4.01 Pezullimi

Sa vijon specifikohen për qëllimet e ndarjes 7.01 (a) (xvii) të termave dhe kushteve standarde:

a) kuadri legjislativ dhe rregullator i zbatueshëm në sektorin e rrugëve në territorin e Huamarrësit do të jetë ndryshuar, pezulluar, shfuqizuar, hedhur poshtë apo hequr dorë në një mënyrë ndryshe nga sa është miratuar nga Banka me shkrim; ose

b) Entiteti i Projektit nuk do të ketë arritur që të përmbushë cilëndo nga detyrimet e tij sipas Marrëveshjes Shtesë të Huasë.

Ndarja 4.02 Shuarja

Nëse në ndonjë kohë Banka përcakton se një pagesë nga, apo çfarëdo përdorim i Llogarisë së Posaçme është bërë jo në përputhje me kërkesat e Programit 3 dhe identifikon shumën e Huasë për të cilën vlen një keqpërdorim i tillë, Banka mund, pas njoftimit që i bën Huamarrësit, të heqë të drejtën e Huamarrësit për të bërë tërheqje në lidhje me një shumë të tillë. Pas dhënies së këtij njoftimi, një shumë e tillë e Huasë do të shuhet.

Neni 5
Efektshmëria

Ndarja 5.01 Kushtet që paraprijnë efektshmërinë

Sa vijon specifikohen për qëllimet e ndarjes 9.02 (c) të termave dhe kushteve standarde si kushte shtesë ndaj efektshmërisë së kësaj Marrëveshjeje dhe Marrëveshjes së Projektit:

a) Marrëveshja Shtesë e Huasë, në formën dhe thelbin e kënaqshëm për Bankën, është zbatuar dhe dërguar, si edhe janë plotësuar të gjitha kushtet që paraprijnë ndaj efektshmërisë së saj apo ndaj të drejtës së Entitetit të Projektit për të bërë tërheqje nën të, përveç vetëm efektshmërisë së kësaj Marrëveshjeje;

b) Huamarrësi do të ketë krijuar njësinë për vënien në jetë të projektit në përputhje me ndarjen 3.02;

c) Entiteti i Projektit do të ketë krijuar njësinë për vënien në jetë të projektit në përputhje me ndarjen 2.03 të Marrëveshjes së Projektit;

d) Entiteti i Projektit do të ketë pajtuar këshilltarët për të cilët bëhet referim në Ndarjen 2.06 (a) (2) të Marrëveshjes së Projektit; dhe

e) Banka do të jetë pajtuar një këshilltar si vëzhgues teknik për të ndihmuar Bankën në vëzhgimin e Projektit.

Ndarja 5.02 Mendimet ligjore

a) Për qëllime të ndarjes 9.03 (a) të termave dhe kushteve standarde, mendimi juridik do të jepet në emër të Huamarrësit nga Ministri i Drejtësisë i Huamarrësit dhe sa vijon specifikohen si çështje shtesë për t'u përfshirë në mendimin që do i jepet Bankës:

1) Marrëveshja Shtesë e Huasë është autorizuar në mënyrën e duhur nga, dhe dërguar në emër të, Huadhënësit dhe përbën një detyrim të vlefshëm e të detyrueshëm ligjërisht të Huadhënësit, të zbatueshëm në përputhje me termat e tij.

b) Për qëllime të ndarjes 9.03 (c) të termave dhe kushteve standarde, mendimi apo mendimet juridike do të jepen në emër të Entitetit të Projektit nga Avokati i Qytetit të Entitetit të Projektit dhe sa vijon specifikohen si çështje shtesë për t'u përfshirë në mendimin apo mendimet që i jepen Bankës:

1) Marrëveshja Shtesë e Huasë është autorizuar apo ratifikuar në mënyrën e duhur nga, dhe zbatuar e dërguar në emër të, entitetit të Projektit dhe përbën një detyrim të vlefshëm e ligjërisht të detyrueshëm të Entitetit të Projektit, të zbatueshëm në përputhje me termat e tij.

Ndarja 5.03 Përfundimi për shkak të mosarritjes së efektshmërisë

Data 90 ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje përcaktohet për qëllimet e ndarjes 9.04 të termave dhe kushteve standarde.

Neni 6
Të ndryshme

Ndarja 6.01 Vërejtje

Adresat në vijim janë specifikuar për qëllime të ndarjes 10.01 të termave dhe kushteve standarde:

Për Huamarrësin:
Ministria e Financës e Republikës së Shqipërisë
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 4
Tiranë, Shqipëri
Në vëmendje të: Ministrit të Financave
Fax : +355-4-228-494
Për Bankën:
Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
(European Bank for Reconstruction and Development)
One Exchange Square
London EC2A 2JN
United Kingdom

Attention / Në vëmendje të: Njësia e Veprimit të Administratës
(Operation Administration Unit)
Fax: +44-20-7338-6100
Telex: 8812161
Answerback: EBRD L G

Palët e pranishme këtu, duke vepruar përmes përfaqësuesve të tyre të autorizuar në mënyrën e duhur, kanë bërë që kjo Marrëveshje të nënshkruhet në katër kopje dhe të dërgohet në Londër, Angli në ditën dhe vitin e shkruar më sipër.

SHTOJCË E PROGRAMIT 2

Kategoria	Shuma e Huasë së lëvruar në monedhën e Huasë	Përqindja e shpenzimeve që do të financohen
(1) Materiale, punë dhe shërbime për pjesën A-1 të Projektit	1,000,000	100% e vlerës së kontratës duke përjashtuar çfarëdolloj takse
(2) Materiale, punë dhe shërbime për pjesën A-2 të Projektit	1,500,000	100% e vlerës së kontratës duke përjashtuar çfarëdolloj takse
(3) Materiale, punë dhe shërbime për pjesën A-3 të Projektit	2,000,000	100% e vlerës së kontratës duke përjashtuar çfarëdolloj takse
(4) Materiale, punë dhe shërbime për pjesën A-4 të Projektit	2,500,000	100% e vlerës së kontratës duke përjashtuar çfarëdolloj takse
(5) Materiale, punë dhe shërbime për pjesën A-5 të Projektit	6,000,000	100% e vlerës së kontratës duke përjashtuar çfarëdolloj takse
(6) Pajisje për pjesët A-1, A-2, A-3 dhe A-4 të Projektit	500,000	100% e vlerës së kontratës duke përjashtuar çfarëdolloj takse
(7) Shërbime këshillimi për projektim dhe mbikëqyrje të pjesës A-1, A-2, A-3 dhe A-4 të	425,000	100% e vlerës së kontratës duke përjashtuar çfarëdolloj takse

Projektit		
(8) Shërbime këshilluese për projektim dhe mbikëqyrje të pjesës A-5 të Projektit	375,000	100% e vlerës së kontratës duke përjashtuar çfarëdolloj takse
(9) Shërbime këshilluese për vëzhgimin (vëzhgimi teknik i Huadhënësit) për pjesët A-1, A-2, A-3, A-4 dhe A-5 të Projektit	154,000	100% e vlerës së kontratës duke përjashtuar çfarëdolloj takse
(10) Komisioni (bankar) i përgjithshëm	146,000	100%
Total	14,600,000	

PROGRAMI 3 – LLOGARI E POSAÇME

1. Për qëllimet e këtij Programi, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimin e mëposhtëm:

"Kategori e Përzgjedhshme" nënkupton kategoritë (1), (2), (3), (4), (5), (6), (7), (8) dhe (9).

"Shpenzime të Përzgjedhshme" nënkupton shpenzimet që pa marrë parasysh koston e arsyeshme të materialeve, punëve dhe shërbimeve të kërkuara për Projektin, do të financohen nga kështet e Huasë dhe të cilat do të caktohen kohë pas kohe në një Kategori të Përzgjedhur në përputhje me parimet e Programit 2.

"Bilanci Maksimal në Llogarinë e Posaçme" nënkupton një shumë të barabartë me EUR, 3,000,000

"Shuma Minimale e Tërheqjes në Llogarinë e Posaçme" nënkupton një shumë të barabartë me EUR, 200,000

2. Pagesat jashtë Llogarisë së Posaçme do të bëhen veçanërisht për Shpenzimet e Përzgjedhura në përputhje me parimet e këtij Programi.

3. Pasi Banka të ketë marrë prova të kënaqshme për të që Llogaria e Posaçme është hapur në kohë në përputhje me afatet dhe kushtet e pranueshme për Bankën, duke përfshirë mbrojtjen e nevojshme kundër kundërshtimeve, konfiskimeve dhe sekuestrimeve, Huamarrësi mund të tërheqë prej Shumës së Disponueshme dhe të depozitojë në Llogarinë e Posaçme një shumë fillestare e cila nuk do të kalojë Bilancin Maksimal të Llogarisë së Posaçme dhe nuk do të jetë më pak se Shuma Minimale e Tërheqjes në Llogarinë e Posaçme.

4. Pas kësaj, Huamarrësi mund të tërheqë shuma shtesë prej Shumës së Disponueshme dhe t'i depozitojë këto shuma në Llogarinë e Posaçme, shuma të cilat duhet t'i nënshtrohen kufizimeve të përcaktuara në paragrafin 6 më poshtë, si dhe përmbushjes së kënaqshme të kushteve të mëposhtme për çdo kërkesë për tërheqje:

a) Huamarrësi duhet t'i ketë paraqitur Bankës gjendjet e llogarisë dhe dokumente, si dhe çdo lloj dëshmie tjetër të kërkuar prej Bankës, për të treguar që shumat e shpenzuara nga Llogaria e Posaçme janë përdorur siç duhet.

b) Pasi tërheqja e kërkuar të jetë realizuar dhe shuma e kësaj tërheqjeje të depozitohet në Llogarinë e Posaçme, bilanci i Llogarisë së Posaçme nuk duhet të kalojë Bilancin Maksimal në Llogarinë e Posaçme.

c) Ndryshe nga sa Banka mund të jetë dakord herë pas here, shuma e kërkuar e tërheqjes për depozitim në Llogarinë e Posaçme, nuk duhet të jetë më pak sesa Shuma Minimale e Tërheqjes në Llogarinë e Posaçme.

5. Pa paragjykuar kërkesat e paragrafit 4(a) më lart, Huamarrësi do të sjellë në çdo kohë që Banka të kërkojë brenda kufijve të pranueshëm, një raport mbi bilancin dhe detaje të tjera të Llogarisë së Posaçme, duke përfshirë gjendjet e llogarisë dhe dokumente dhe dëshmi të tjera siç mund t'i kërkojë Banka për të treguar që pagesat e bëra prej Llogarisë së Posaçme janë bërë në përputhje me kërkesat e vendosura në këtë Program.

6. Por sipas përcaktimeve të paragrafit 4 të këtij Programi, Huamarrësi nuk duhet të tërheqë fonde, përveç rastit kur Banka ka rënë dakord, prej Shumës së Disponueshme për depozitim në llogarinë e Posaçme:

a) në qoftë se, në çdo kohë, Banka ka përcaktuar që të gjitha tërheqjet e mëtejshme duhet të bëhen në përputhje me parimet e paragrafit 2.03(a); ose

b) atëherë kur Shuma e Disponueshme e akorduar në Kategoritë e Përzgjedhura barazon dyfishin e shumës së Bilancit Maksimal në Llogarinë e Posaçme.

Prandaj, Tërheqjet e caktuara për Kategoritë e Përzgjedhura do të ndjekin këto procedura sikurse Banka mund të specifikojë duke njoftuar Huamarrësin. Të tilla tërheqje të tjera do të bëhen vetëm pasi dhe deri në kufirin që Banka është e kënaqur që të gjitha shumat e mbetura në depozitën e Llogarisë së Posaçme sipas datës së njoftimit do të përdoren për të bërë pagesa për Shpenzime të Përzgjedhura.

7. Në rast se Banka përcakton në çdo kohë që ndonjë pagesë e jashtme ose ndonjë përdorim i Llogarisë së Posaçme:

a) është bërë për një shpenzim ose në një shumë jo të përzgjedhur në pajtim me paragrafin 2 të këtij Programi; ose

b) nuk është justifikuar nga dëshmitë e paraqitura Bankës,

atëherë Banka mund t'i kërkojë Huamarrësit:

1. të sigurojë dëshmi shtesë sikurse kërkohen nga Banka; dhe/ose

2. të depozitojë në Llogarinë e Posaçme (ose, në rast se Banka e kërkon kështu, të paguajë Bankën) një shumë të njëjtë me këtë pagesë ose pjesën jo dhe aq të përzgjedhur apo të justifikuar.

Në rast se Banka bën një përcaktim të tillë sipas (a) dhe (b) më lart, nuk do të bëhen tërheqje të mëtejshme për depozitim në Llogarinë e Posaçme, vetëm në rast se Banka bie dakord ndryshe, deri në një kohë kur Huamarrësi të ketë ose (A) depozituar në Llogarinë e Posaçme ose t'i ketë ripaguar Bankës një shumë të njëjtë me këtë pagesë (ose pjesë) e përcaktuar si jo e përzgjedhur apo e justifikuar, ose (B) t'i paraqiten dëshmi shtesë të kënaqshme për Bankën që shumat e paguara më parë prej Llogarisë së Posaçme janë përdorur siç duhet.

8. Në qoftë se:

a) Banka përcakton në çdo kohë që çdo shumë e papaguar në Llogarinë e Posaçme nuk do të kërkohet për të mbuluar pagesa të mëtejshme për Shpenzime të Përzgjedhura;

ose

b) Banka e drejton Huamarrësin të paguajë një shumë në pajtim me paragrafin 7(2);

atëherë Huamarrësi, menjëherë pas njoftimit të Bankës, do të paguajë në Bankë një pjesë të Huasë të njëjtë me këtë shumë. Për këtë qëllim, kërkesa që parapagesat e Huasë të bëhen në Datat e Pagesës së Interesit, e përcaktuar në paragrafin 10 më poshtë, do të hiqet.

9. Huamarrësi duke lajmëruar paraprakisht Bankën, në përputhje me paragrafin 3.07(a) të Termave dhe Kushteve Standarde, mund të parapaguajë në çdo Datë të Pagesës së Interesit, të gjitha ose një pjesë të fondeve të depozituara në Llogarinë e Posaçme.

10. Çdo parapagesë në pajtim me paragrafin 8 dhe 9 më lart do të bëhet në përputhje me paragrafin 3.07 të Termave dhe Kushteve Standarde; duke marrë parasysh, gjithsesi që: (a) pavarësisht nga paragrafi 3.07(c)(i)(A) i Termave dhe Kushteve Standarde, këto parapagesa nuk do t'i nënshtrohen Shumës Minimale të Parapagesës, dhe (b) çdo parapagesë që bëhet në një datë tjetër me atë të Datës së Pagesës së Interesit do t'i nënshtrohet Kostos së Palikuiduar në përputhje me paragrafin 3.10 të Termave dhe Kushteve Standarde. Çdo parapagesë, duke marrë parasysh paragrafët 8 dhe 9 më lart, do të zbatohet nga Banka në përputhje me paragrafin 3.07(c)(ii) të Termave dhe Kushteve Standarde.

PROGRAMI 1 – PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

1. Qëllimi i Projektit është të ndihmojë Huamarrësin në rehabilitimin dhe zhvillimin e rrugëve në Bashkinë e Tiranës.

2. Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme të cilat mund t'i nënshtrohen ndryshimeve të herëpashershme në rast se Banka dhe Huamarrësi bien dakord:

Pjesa A: Programi i Investimit

A-1: Rehabilitimi dhe përmirësimi i Unazës së Tiranës midis Zogut të Zi dhe Stacionit të Trenit

A-2: Rehabilitimi dhe përmirësimi i Unazës së Tiranës midis Stacionit të Trenit dhe Rrugës "Dibra"

A-3: Rehabilitimi dhe përmirësimi i Unazës së Tiranës midis Rrugës "Dibra" dhe Bulevardit "J d'Arc".

A-4: Rehabilitimi dhe përmirësimi i rrugës së Kavajës dhe Rrugës së Unazës së Madhe në kryqëzim.

A-5: Rehabilitimi dhe përmirësimi i kryqëzimit të Kamzës.

Pjesa B: Programi i Zhvillimit Institucional

B-1: Zhvillimi institucional i drejtimit financiar të Njësisë së Projektit duke përfshirë aftësitë e tij për të monitoruar dhe kontrolluar të ardhurat dhe shpenzimet, si dhe për të planifikuar shpenzimet e dorës së parë. (kapitale)

B-2: Zhvillimi institucional i Njësisë së Projektit për drejtimin e transportit të Bashkisë.

3. Projekti pritet të përfundojë më 31 dhjetor 2008.

PROGRAMI 2 – KATEGORITË DHE TËRHEQJET

1. Tabela e bashkëngjitur me këtë Program përcakton kategoritë, shumën e Huasë së caktuar për secilën kategori dhe përqindjen e shpenzimeve që do të financohen në secilën kategori.

2. Pavarësisht nga përcaktimet në paragrafin 1 më lart, nuk do të bëhen tërheqje për shpenzimet që janë bërë përpara datës së Marrëveshjes së